



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.130**

**3 tetor**

**2007**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9807 datë 20.9.2007	Për disa ndryshime në ligjin nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, të ndryshuar ..... 3631
Ligj nr.9808 datë 24.9.2007	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar ..... 3631
Vendim i KM nr.623, datë 29.9.2007	Për prokurimin e prodhimeve/transmetimeve të reklamave dhe spoteve nga organet e administratës shtetërore në media ..... 3638

**LIGJ**  
**Nr.9807, datë 20.9.2007**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7892, DATË 21.12.1994 “PËR  
SPONSORIZIMET”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 5 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në shkronjën “a” fjalët “deri në masën 4 për qind të fitimit para tatimit” zëvendësohen me fjalët “deri në masën 3 për qind të fitimit para tatimit”.
2. Shkronja “b” shfuqizohet.
3. Në shkronjën “c” fjalët “deri në masën 10 për qind të fitimit para tatimit” zëvendësohen me fjalët “deri në masën 5 për qind të fitimit para tatimit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5467, datë 28.9.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr.9808, datë 24.9.2007**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.8378, DATË 22.7.1998 “KODI  
RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 pika 2 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

## Neni 1

Në nenin 7 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 shkronja “f”, në fund të fjalisë hiqen fjalët “sipas udhëzimeve të ministrisë që mbulon veprimtarinë përkatëse”.

2. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Pjesa e të ardhurave nga parkimet me pagesë, që i takon entit pronar të rrugës, destinohet për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, sinjalizimit rrugor dhe zgjerimin e hapësirave të destinuara për parkim.”.

3. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

“8. Në rastin kur bashkia ose komuna përcakton zona parkimi me pagesë, sipas shkronjës “f” të pikës 1 të këtij neni, administrimi i këtij shërbimi, me vendim të këshillit përkatës, mund të kryhet:

a) drejtpërdrejt nga strukturat e bashkisë ose komunës përkatëse;

b) për parkimet nëntokësore, me koncesion, sipas ligjit nr. 9663, datë 18. 12. 2006 “Për koncesionet”;

c) për parkimet në rrugë, nga subjekt privat i përzgjedhur nga bashkia/komuna, me të cilin kjo e fundit mund të lidhë një kontratë shërbimi dhe/ose të krijojë një shoqëri tregtare të përbashkët, ose të zgjedhë çdo formë tjetër bashkëpunimi që lejon legjislacioni në fuqi.

Rregullat, kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për përzgjedhjen e subjektit, sipas shkronjës “c” të paragrafit të parë të kësaj pike, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportin.

Ngarkohet ministri përgjegjës për transportin të nxjerrë udhëzimet përkatëse brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Bashkia/komuna, duke u mbështetur në nevojat për parkim, drejton dhe organizon shërbimin, në zbatim të udhëzimit të ministrit.

Kryetari i bashkisë/komunës, duke u bazuar në udhëzimin e ministrit, zhvillon procedurën për përzgjedhjen e subjektit dhe lidh kontratën me të.

Bashkia/komuna që përcakton zona të parkimit me pagesë, sipas pikës 1 shkronja “f” të këtij neni, është e detyruar që, në pjesë të kësaj zone parkimi ose në zona të tjera në afërsi të saj, të rezervojë një sipërfaqe të përshtatshme, të destinuar për parkim pa pagesë. Një detyrim i tillë përjashtohet për zonat e përcaktuara në nenin 3 si “zona këmbësore urbane” dhe “zona me trafik të kufizuar”, si dhe në zona të tjera me rëndësi të veçantë urbanistike, ku ka kërkesa dhe kushte të veçanta trafiku.”.

## Neni 2

Në nenin 12 bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Në pikën 1 shtohet shkronja “c” si më poshtë:

“c) policisë së bashkisë, në bashkitë me popullsi më të madhe se 20 000 banorë, për territorin në juridiksion, vetëm për shkeljet që kanë të bëjnë me parkimet, të kryera në rrugët që janë në administrim/pronë të bashkisë, të parashikuara në nenin 7, me përjashtim të pikës 12 të tij, nenin 11 pika 1 shkronjat “a” dhe “e”, nenin 85, 86, 87, 89, 155 pika 6, 156 pika 1 shkronjat “g” dhe “h”, pika 2 shkronjat “d”, “e”, “g”, “h”, “i”, “j”, “k” dhe “l””.

2. Në pikën 3, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “c/1” si më poshtë:

“c/1) punonjësit e subjektit privat, kur administrimi i parkimeve me pagesë bëhet sipas nenit 7 pika 8 shkronja “c” të këtij Kodi, kur kjo kompetencë i delegohet nga këshilli i bashkisë, në bashkitë me popullsi më të madhe se 20 000 banorë;”.

## Neni 3

Neni 35 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 35  
**Kompetencat**

1. Ministri, që mbulon veprimtarinë përkatëse, është kompetent për nxjerrjen e urdhrave dhe udhëzimeve për organizimin e qarkullimit dhe të sinjalizimit përkatës rrugor, pasi ka marrë mendimin e ministrive që mbulojnë veprimtarinë mjedisore dhe bashkërendojnë problemet e qeverisjes vendore dhe decentralizimit, për çështjet brenda kompetencave të saj, për të gjitha rrugët, përjashtuar ato që janë vetëm për përdorim ushtarak, për të cilat kompetencat i ka komanda ushtarake e territorit. Ajo përcakton, gjithashtu, normat dhe kriteret ku duhet të mbështeten entet pronare të rrugëve, për planifikimin e trafikut, për rastet e përcaktuara në aktet që dalin në zbatim të Kodit.

2. Ministri, që mbulon veprimtarinë përkatëse, është i autorizuar të përshtatë me aktet e veta, normat e rregullores për sinjalizimin rrugor, sipas nenit 44 të këtij Kodi.

3. Ministri, që mbulon veprimtarinë përkatëse, nxjerr akte për sigurinë rrugore dhe auditimin e saj, sipas përcaktimeve në aktet në zbatim, si dhe urdhëron kontrollin e zbatimit të tyre.”.

Neni 4

Neni 36 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 36  
**Planet urbane të trafikut, planet e trafikut për lëvizjen interurbane  
dhe plani interurban i trafikut**

1. Bashkitë me popullsi mbi 20 000 banorë janë të detyruara të hartojnë planet urbane të trafikut.

2. Detyrimit të pikës 1 i nënshtrohen edhe bashkitë e komunat me popullsi më të vogël se 20 000 banorë, ku regjistrohet, gjatë vitit, një fluks turistësh, si rezultat i rritjes së turizmit ditor ose ato që duhet të zgjidhin probleme të veçanta për shkak të bllokimeve të trafikut rrugor. Lista e këtyre bashkive dhe komunave hartohet nga këshilli i qarkut dhe publikohet nga ministria përkatëse që mbulon këtë fushë.

3. Këshillat e qarqeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve hartojnë planet e trafikut për lëvizjen interurbane, në bashkëpunim me bashkitë, komunat dhe entet e tjera pronare.

4. Plan i trafikut urban synon përmirësimin e kushteve të qarkullimit dhe sigurisë rrugore, uljen e ndotjes akustike, atmosferike dhe kursimin e energjisë, në përputhje me rregullat urbanistike dhe me planin e transportit, për ruajtjen e vlerave mjedisore, duke përcaktuar përparësitë dhe kohën e zbatimit të tyre. Plan i urban i trafikut parashikon pajisjen me sisteme të përshtatshme teknologjike, të informatizuara për rregullimin dhe kontrollin e trafikut, nëpërmjet verifikimit të ngadalësimeve dhe qëndrimeve, për rregullimin e fluksit të trafikut rrugor, i domosdoshëm për realizimin e objektivave të përcaktuara.

5. Këshillat e qarqeve, bashkitë dhe komunat hartojnë dhe përditësojnë planet urbane të trafikut dhe planet për lëvizjen interurbane, sipas kriterëve, urdhrave dhe udhëzimeve të nxjerra nga ministri që mbulon veprimtarinë përkatëse, në bashkëpunim me ministrinë që mbulon veprimtarinë mjedisore, mbështetur në planin kombëtar të transportit.

6. Planet urbane të trafikut rishikohen çdo dy vjet. Kryetarët e këshillave të qarqeve, të bashkive dhe komunave janë të detyruar të informojnë edhe ministrinë, që mbulon veprimtarinë përkatëse, për futjen e të dhënave në sistemin informativ të arkivit kombëtar, sipas pikës 2 të nenit 221 të Kodit.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve harton planin interurban të trafikut të mjeteve për akset kryesore kombëtare, të cilin e miraton ministria që mbulon veprimtarinë përkatëse. Plan i interurban i trafikut rishikohet çdo dy vjet.”.

## Neni 5

Në nenin 61 bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Në pikën 1 shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) gjerësi maksimale jo më të madhe se 2,55 m. Në llogaritjen e kësaj gjerësie nuk futen pasqyrat e lëvizshme, të shikimit prapa;”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Gjysmërimorkiororët dhe artikularët mund të kenë, duke përfshirë dhe mekanizmat e tërheqjes, gjatësi maksimale 16,50 m, me kusht që të jenë respektuar edhe kufizimet e tjera, të përcaktuara në aktet në zbatim; autobusët dhe trolejbusët artikularë, të linjave të shërbimit publik të pasagjerëve, që qarkullojnë në itinerare të përcaktuara, mund të kenë gjatësi maksimale deri 18 m; autotrenat dhe trolejbusët me rimorkio mund të kenë gjatësi maksimale deri në 18,75 m, me kusht që të jenë respektuar edhe kufizimet e tjera, të përcaktuara në aktet në zbatim.”.

3. Në pikën 3 fjalia e fundit ndryshohet si më poshtë:

“Gjerësia e autokampeve dhe rimorkiove kamp nuk duhet të jetë më e madhe se 2,55 m dhe lartësia maksimale nga toka nuk duhet të kalojë 1,8 herë largësinë minimale (në aksin tërthor), ndërmjet rrotave të mjetit.”.

4. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

“5/1. Për mjetet motorike M2 e M3 dhe rimorkiot e tyre, në kategorinë O dhe mjetet motorike N2 e N3 dhe rimorkiot e tyre, në kategoritë O3 dhe O4, siç përcaktohen në nenin 47 të këtij ligji, të destinuara për transport, të brendshëm dhe ndërkombëtar, udhëtarësh dhe mallrash, përcaktimi i përmasave maksimale të lejuara bëhet në përputhje me dispozitat e përmendura në këtë ligj dhe/ose me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të këtij ligji.”.

## Neni 6

Në nenin 62 bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Pesha e përgjithshme, me ngarkesë të plotë, e një rimorkioje me një aks nuk mund të jetë më e madhe se 6 tonë, 18 tonë për ato me dy akse dhe 24 tonë për ato me tri akse.”.

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Pesha e përgjithshme, me ngarkesë të plotë, e një gjysmërimorkiatori ose autotreni, kur plotësojnë kushtet e pikave 2, 3 e 6, nuk duhet të jetë më e madhe se 36 tonë, kur kanë katër akse, 40 tonë kur kanë pesë ose gjashtë akse, 44 tonë kur kanë pesë ose gjashtë akse në transportin e kombinuar, që mbartin konteinerë 40 këmbë, sipas ISO-s.”.

3. Në pikën 6 fjalia e parë e paragrafit të dytë ndryshohet si më poshtë:

“ – 11,5 tonë, kur largësia aksiale është më e vogël se një metër.”.

4. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

“6/1. Përcaktimi i peshave maksimale të lejuara dhe karakteristikave të tjera, për mjetet e përmendura në pikën 5/1 të nenit 61, bëhen në përputhje me dispozitat e përmendura në këtë ligj dhe/ose me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të këtij ligji.”.

## Neni 7

Në nenin 79 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Ministri, që mbulon veprimtarinë përkatëse, përcakton, me urdhër dhe udhëzim të veçantë, kriteret, kohën dhe mënyrat e kryerjes së kontrollit teknik të kategorive të mjeteve me motor dhe të rimorkiove, për të garantuar sigurinë dhe qetësinë në qarkullim dhe se ndotja e shkaktuar prej tyre nuk i kalon kufijtë e përcaktuar. Kontrollat teknike, vjetore dhe periodike, kryhen në qendrat e kontrollit teknik, të licencuara nga ministria, që mbulon veprimtarinë përkatëse, sipas kriteve të përcaktuara në aktet në fuqi. Në udhëzim përcaktohen elementet, për të cilat duhet

të kryhet kontrolli teknik i sistemeve të mjeteve, që kanë rëndësi për sigurinë e tyre.”.

2. Në pikën 3, në fjalinë e parafundit fjalët “brenda dy vjetësh” zëvendësohen me fjalët “brenda një viti”.

3. Në pikën 10, në fjalinë e parafundit hiqen fjalët “të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.”.

#### Neni 8

Në nenin 80 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kontrollat teknike, të parashikuara nga ky Kod, për mjetet me motor dhe mjetet që ato tërheqin kryhen nga punonjësit e qendrave të kontrollit teknik, të diplomuar inxhinierë mekanikë ose teknikë, mekanikë transporti.”.

2. Në pikën 2, fjalët “nëpunësit e zyrave” zëvendësohen me fjalët “punonjësit e qendrave”.

#### Neni 9

Në nenin 82 fjalia e parafundit e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për automjetet, kapaciteti transportues i të cilave është deri në 1,5 ton.”.

#### Neni 10

Në nenin 83 pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Mund të caktohen për dhënie me qira të gjitha mjetet me motor dhe rimorkiot e tyre, përfshirë edhe mjetet e caktuara për transportin e mallrave, me ngarkesë të plotë, e cila është mbi 1,5 ton, si dhe mjetet, të ndryshme nga autoveturat, të caktuara për transportin e njerëzve.”.

#### Neni 11

Në nenin 87 fjalia e parafundit e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për automjetet, kapaciteti transportues i të cilave është deri në 1,5 ton.”.

#### Neni 12

Në nenin 119 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Lejedrejtimi i mjetit merret pas provës së kontrollit të njohurive teorike dhe pas provës së verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes.”.

2. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

“8. Prova e kontrollit të njohurive teorike jepet pas përfundimit të programit teorik, sipas kategorisë së lejedrejtimit. Pas kalimit të provës së njohurive teorike me rezultat pozitiv, kandidati pajiset nga drejtoria rajonale e shërbimit të transportit rrugor me autorizimin për ushtrimin e drejtimit të mjetit.”.

3. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:

“10. Në aktet e dala në zbatim të këtij Kodi, përcaktohen afatet kohore për ripërsëritjen e provimit, në rastin e një rezultati negativ në provimin e mëparshëm.”.

#### Neni 13

Në nenin 120 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 1, në fund të fjalisë shtohen fjalët “pasi të ketë kaluar provën e njohurive

teorike me rezultat pozitiv”.

2. Në pikën 2 shprehja “jo më të madhe se 60 vjeç” bëhet “jo më të madhe se 65 vjeç”.
3. Në pikën 6 shprehja “deri në tri herë” zëvendësohet me shprehjen “deri në pesë herë”.

#### Neni 14

Në nenin 150, në fund të pikës 1 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Drejtuësit e mjeteve me motor, gjatë të gjithë kohës së lëvizjes në autostrada dhe rrugë interurbane, janë të detyruar të përdorin fenerët joverbues dhe, kur është parashikuar, dritat e pengesës.

Drejtuësit e çiklomotorëve dhe të motomjeteve, gjatë të gjithë kohës së lëvizjes, në të gjitha llojet e rrugëve, janë të detyruar të përdorin fenerët joverbues.”.

#### Neni 15

Në nenin 155 pika 8 ndryshohet si më poshtë:

“8. Cilido që shkel dispozitat e këtij neni, ndëshkohet me masë administrative me gjobë në vend me shumën pesëqind deri në tre mijë lekë.”.

#### Neni 16

Në nenin 156 pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Cilido që shkel dispozitat e këtij neni ndëshkohet me masë administrative me gjobë në vend me shumën pesëqind deri në tre mijë lekë.”.

#### Neni 17

Në nenin 157 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 fjalia e parë fjalët “organet e policisë” zëvendësohen me fjalët “organet dhe strukturat”.

2. Në pikën 3, pas fjalisë së dytë shtohet fjalia “Zhblokimi i mjetit bëhet vetëm mbasi është kryer pagesa e gjobës në vend, sipas nenit 155 pika 8, nenit 156 pika 6 dhe nenit 200 të këtij Kodi.”.

3. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Organet dhe strukturat e përmendura në nenin 12 mund të veprojnë edhe me heqjen e mjeteve, kur, duke u nisur nga gjendja e tyre ose nga ndonjë arsyetim tjetër i bazuar, gjykohet se janë braktisur.”.

#### Neni 18

Në nenin 166 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Transporti, me rrugë, i mallrave të rrezikshme kryhet në bazë të ligjeve në fuqi dhe të akteve nënligjore në zbatim të tyre.”.

2. Pikat 2, 3, 4, 5, 6 e 9 shfuqizohen, me hyrjen në fuqi të ligjeve të nxjerra në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

#### Neni 19

Në nenin 170 shkronja “c” e pikës 3 shfuqizohet.

#### Neni 20

Në nenin 172 pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kohëzgjatja e udhëtimit të automjeteve të caktuara për transportin e njerëzve e të mallrave dhe kontrollet përkatëse, të kryera në rrugë ose në zyrat e ndërmarrjes, rregullohen me ligjet në fuqi dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.”.

#### Neni 21

Në nenin 187 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Përdoruesi i rrugës, në rast aksidenti, që në njëfarë mënyre lidhet me sjelljen e tij, është i detyruar të ndalojë dhe t’u japë ndihmën e nevojshme njerëzve të dëmtuar. Kursi i ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti kryhet nga Kryqi i Kuq Shqiptar, në bashkëpunim me autoshkollat, sipas tarifave të miratuara nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Shëndetësisë. Përdoruesi i rrugës është i detyruar të njoftojë shërbimet e emergjencës mjekësore dhe të Policisë Rrugore.”.

2. Pikat 3 dhe 9 shfuqizohen.

#### Neni 22

Në nenin 203 pika 1 fjalia e parë, pas fjalëve “formë të prerë” shtohen fjalët “me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon gjobë në vend”.

#### Neni 23

Në nenin 209 pika 1 fjalët “organi i policisë” zëvendësohen me fjalët “organi dhe struktura e përmendur në nenin 12”.

#### Neni 24

Në nenin 211 pika 3 fjalët “organet e policisë” zëvendësohen me fjalët “organet dhe strukturat e përmendura në nenin 12”.

#### Neni 25

##### **Dispozita kalimtare**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 61, 62, 166 dhe 172 të Kodit Rrugor brenda 24 muajve.

#### Neni 26

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5468, datë 28.9.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**



**VENDIM**  
**Nr.623, datë 29.9.2007**

**PËR PROKURIMIN E PRODHIMEVE/TRANSMETIMEVE TË REKLAMAVE DHE  
SPOTEVE NGA ORGANET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE NË MEDIA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**I. Rregulla të përgjithshme**

1.1 Ky vendim ka për qëllim vendosjen e rregullave dhe përcaktimin e procedurave, që ndiqen për prokurimin e prodhimeve/transmetimeve të reklamave dhe spoteve në median e shkruar dhe atë vizive.

1.2 Në kuptim të këtij vendimi me termat e mëposhtme nënkuptohet:

a) “Reklama dhe spote” – janë mesazhet, që synojnë të nxisin shitblerjen e një malli ose kryerjen e një shërbimi, duke paraqitur një ide, për të arritur efektet, që dëshiron reklamuesi, të cilit i është dhënë kohë transmetimi me pagesë ose me një formë tjetër shpërblimi.

b) “Transmetim” – është emetimi i parë me transmetues tokësor, me kablo ose satelit, në formë të koduar a të pakoduar, i shërbimeve programore radio dhe/ose televizive, që i drejtohen publikut në përgjithësi.

c) “Transmetues” – është personi juridik, që ofron rrjetin e transmetimit ose një shërbim transmetimi për publikun, sipas kushteve dhe standardeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

ç) Media – Ky term u referohet të gjitha mjeteve të komunikimit për publikim periodik të informacioneve, pavarësisht nëse jepen *on line* a *offline*, si gazeta, revista, radio, televizion apo shërbime të reja, bazuar në web-e.

1.3 Reklama dhe spoti duhet të bazohen në fakte dhe të jenë në përputhje me interesat, shtetërore dhe politike, të shtetit shqiptar dhe me rendin kushtetues në Republikën e Shqipërisë.

1.4 Reklama dhe spoti nuk duhet të përmbajnë informacion të rremë apo shqetësues për shikuesit.

1.5 Ky vendim zbatohet nga organet e qeverisjes qendrore e vendore, si dhe nga institucionet e tjera publike, të pavarura, për transmetimin e reklamave dhe spoteve në televizionet ndërkombëtare, kombëtare dhe vendore, në radiot, me shtrirje ndërkombëtare, kombëtare apo vendore ose në gazetatat e revistat, me shtrirje ndërkombëtare, kombëtare apo vendore.

**II. Procedura e prodhimit dhe e transmetimit të reklamës**

2.1 Titullari i institucionit urdhëron, me shkrim, prodhimin/transmetimin e reklamës dhe spotit, duke parashikuar, në mënyrë të arsyetuar, objektin, nevojën e kryerjes së reklamës, shpeshhtësinë e shfaqjes së saj dhe fondin limit, të vënë në dispozicion.

2.2 Për kryerjen e procedurave të nevojshme të prokurimit për prodhimin/transmetimin, si dhe dokumentimin e kostove të tregut të prodhimit/transmetimit të reklamës dhe spotit krijohet komisioni i vlerësimit, në përbërje të të cilit marrin pjesë, detyrimisht, drejtuesi i zyrës juridike, shefi i sektorit të financës dhe 3 specialistë, me njohuri në fushën përkatëse.

2.3 Komisioni, brenda një periudhe kohore 5 ditëshe, studion tregun në fushën e prodhimit/transmetimit të reklamave dhe spoteve dhe shpërndan, me korrespondencë zyrtare, në organet e medias/masmedias/të agjencive të specializuara, ftesën për paraqitje ofertash. Ftesa duhet të përmbajë objektin e prokurimit, fondin limit, kushtet specifike, të kërkuara, dhe datën përfundimtare të paraqitjes së ofertës.

Këto të dhëna pasqyrohen edhe në faqen e internetit të institucionit, me opsionin e shkarkimit të formularëve dhe të dokumenteve të tjera të kërkuara. Nga ana e tij, zëdhënësi i shtypit

njofton, po në rrugë elektronike organet e medias.

2.4 Komisioni, i cili pret ofertat deri në datën dhe orën e caktuar në ftesën përkatëse, garanton fshehtësinë dhe moshapjen e tyre para orës së caktuar. Pas hapjes së ofertave, komisioni shpall publikisht ofertat dhe çmimin për secilin kandidat, si dhe i publikon ato në faqen e internetit. Ofertuesit apo përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë të jenë të pranishëm gjatë procesit të hapjes së ofertave.

2.5 Në përfundim të këtij procesi, komisioni harton një raport të hollësishëm për të gjithë procedurën e ndjekur, kërkesat kryesore, që u janë paraqitur ofertuesve, ofertat e ardhura/ofertat e skualifikuara, për mosplotësim të kriterëve teknike, çmimet përkatëse të tyre, si dhe i rekomandon titullarit të institucionit shpalljen e fituesit/fituesve.

Komisioni për sa më lart bazohet në:

a) Rastin e prodhimit:

- në çmimin e dhënë; kur plotësohen kërkesat teknike, të përcaktuara nga komisioni i vlerësimit, çmimi më i ulët ka përparësi.

b) Rastin e transmetimit:

- në numrin e shikuesve/lexuesve të televizionit radios apo shtypit të shkruar, duke shfrytëzuar të dhëna nga autoritetet e specializuara publike, të cilat i bashkëlidhen raportit;

- në çmimin e dhënë; kur plotësohen kërkesat teknike, të përcaktuara nga komisioni i vlerësimit, çmimi më i ulët ka përparësi.

Në rastet e ofertave të dyfishta për prodhim dhe transmetim ka përparësi numri i shikuesve/lexuesve të televizionit/radios apo shtypit të shkruar.

2.6 Titullari i institucionit, në bazë të rekomandimit të dhënë nga komisioni i vlerësimit, vendos, brenda 2 ditësh, shpalljen e fituesit ose përsëritjen e konkurrimit, duke dhënë edhe udhëzimet e nevojshme.

III. Dispozita të fundit

3.1 Një kopje e të gjithë praktikës së mësipërme i dërgohet APP-së për botim.

3.2 Ankesat për procedurën e prodhimit/transmetimit të reklamës dhe spotit i drejtohen drejtuesit të institucionit. Vendimi i tij është përfundimtar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Sali Berisha**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)  
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR
3. REGJISTRAT E NOTERISË
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

## BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

### *Së shpejti në treg:*

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat
- Kodi i familjes (përfshirë legjislacioni për birësimet)

Hyri në shtyp më 3.10.2007  
Doli nga shtypi më 3.10.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”  
Tiranë, 2007

Çmimi 12 lekë